



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201601143/5

Tiranë ___/___/2016

Lënda : *Rekomandim për zgjidhjen konform akteve normative në fuqi të rastit të bllokimit të armës së gjahut shtetasit I.P.*

Drejtuar : Drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë
Z. Ervin HODAJ

Tiranë

Shefit të Komisarariatit të Policisë nr. 3
Z. Ervin HASRAMA

Tiranë

Të nderuar zotërinj,

Në Institucionin e Avokatit të Popullit ka bërë ankesë shtetasi I.P., me banim në Njësinë Administrative nr. 11, Rr. "Mark Prekperaj", Tiranë. Ankuesi shkruan se, para dy vitesh specialisti i policisë së zonës Artan Buzo i ka bllokuar armën e gjahut, teke, të cilën e ka blerë dhe e ka mbajtur me leje. Megjithëse ka kaluar një kohë relativisht e gjatë dhe tej afatit ligjor, arma e gjahut nuk i është kthyer. Ai me të drejtë kërkon që ti kthehet arma e gjahut, sepse është pronë e tij, ose nëse sipas ligjit nuk i takon ta mbajë atë, ti jepen lekët e saj.

Në bazë të kërkesës tonë, Komisarati i Policisë nr. 3 Tiranë me shkresën nr. 3637/1 Prot., datë 08.06.2016, ndërmjet të tjerave na informoi se, shtetasit I.P. i është bllokuar arma e gjahut tip "Teke" për arsye se në datën 28.10.2013, ka ndodhur një konflikt në mes të vëllait të tij, shtetasit P.P. dhe kunatit të tij, shtetasit T.C.. Ky i fundit ka qëlluar me armë zjarri luftarake të tipit "Automatik" shtetasin P.P.. Për pasojë ky shtetas ka mbetur i plagosur dhe tani është jashtë rrezikut për jetën. Për këtë arsye nga ana e Komisarariatit të Policisë nr. 3 Tiranë është bërë arrestimi i autorit, shtetasit T.C., i cili është dënuar me 20 vjet burgim.

Me qëllim që të parandalohet ndodhja e ndonjë ngjarjeje tjetër ndërmjet personave dhe familjeve të përfshirë në konflikt, i është bllokuar përkohësisht arma e gjahut shtetasit I.P., sepse është vlerësuar si mjet i rrezikshëm për jetën dhe i mundshëm për tu përdorur në këtë konflikt. Gjithashtu në këtë shkresë

jepet edhe sqarimi se të dy familjet e personave të cituar më sipër, përveç se kanë lidhje miqësore janë edhe komshinjë.

Nga shqyrtimi i kësaj ankesë dhe i përgjigjes së dërguar nga Komisariati i Policisë nr. 3 Tiranë arrijmë në konkluzionin se, bllokimi i armës së gjahut nga punonjësit e policisë, për një kohë rreth 2 vjet e 7 muaj është i paligjshëm dhe vjen në kundërshtim me nenin 108/3 të ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit, sipas të cilit afati maksimal i bllokimit të sendeve është 90 ditë. Bllokimi i armës së gjahut për një kohë kaq të gjatë, sikurse ka ndodhur në këtë rast, nuk parashikohet as në dispozitat e akteve normative që kanë qënë në fuqi në atë kohë, ligjin nr. 99/2013, si dhe në ligjin që është në fuqi aktualisht nr. 74/2014 “Për armët” dhe aktet nënligjore që kanë dalë në bazë dhe për zbatimin e tyre.

Ky veprim i policisë ka sjellë shkeljen e të drejtës ligjore të ankuesit për të poseduar e gëzuar lirisht pronën e tij të ligjshme (armën e gjahut) të garantuar nga dispozitat e Kodit Civil. Nëse shtetasi I.P. ka shkelur kriteret ligjore për mbajtjen e armës së gjahut, nga komisioni përkatës duhet të veprohet konform dispozitave ligjore që ishin në fuqi në kohën e bllokimit të armës, duke ia hequr atij lejen e dhënë për të mbajtur armën e gjahut dhe bërë shitjen e kësaj arme duke zbatuar procedurat përkatëse.

Gjithashtu nga ankesa e qytetarit I.P. dhe nga përgjigjia e dërguar nga Komisariati i Policisë nr. 3 Tiranë, të cilën e cituam më sipër, nuk rezulton që nga punonjësit e policisë që kanë kryer veprimet në këtë rast të jetë mbajtur procesverbal i bllokimit të përkohshëm të armës së gjahut dhe dhënia e kopjes së tij personit të cilit iu bllokua sendi (ankuesit).

Për sa më sipër dhe me qëllim parandalimin e rasteve të tilla në të ardhmen, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe në gjurmën “b” të nenit 21 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

REKOMANDOJMË

1. Marrjen e masave të nevojshme për zgjidhjen përfundimtare dhe konform dispozitave të akteve normative në fuqi të problemit të bllokimit të armës së gjahut shtetasit I.P..

2. Zbatimin me korrektesë nga punonjësit e policisë të detyrimeve që rrjedhin nga neni 121 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, lidhur me rastet dhe afatet kohore të bllokimit të sendeve, si dhe për hartimin e procesverbalit të bllokimit të sendeve dhe dhënien e kopjes së tyre poseduesve.

3. Marrjen e masave të nevojshme për përgjithësimin e këtij rasti në efektivin e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, pavarësisht faktit që ai ka

ndodhur para më shumë se dy vitesh, me qëllim që raste të tilla të mospërsëriten më në të ardhmen në organet tuaja.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi të na ktheni përgjigje brenda afatit ligjor prej 30 ditësh të parashikuar në nenin 22 të ligjit "Për Avokatin e Popullit".

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI